

VENDIM
Nr.9, datë 10.1.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.67, DATË 22.1.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË SHENJAVE DALLUESE TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2002 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.67, datë 22.1.2004 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje

“1/1. Ministri i Brendshëm miraton:

- a) Rregulloren e uniformës së punonjësit të Gardës;
- b) Normat e materialeve të veshmbathjes, që janë në inventar të njësive, nënjesive dhe grupeve;
- c) Normat e furnizimit me veshmbathje të gardistëve, nënoficerëve dhe oficerëve të Gardës;
- ç) Normat e furnizimit me veshje civile të punonjësve të Gardës ose të konvertimit të tyre në vlerë

në lekë;

d) Normat e materialeve të konsumit dhe të mirëmbajtjes;

dh) Normat e pajisjeve për qentë;

e) Normat e veshmbathjes së posaçme dhe të rrobave të punës për profesionet e ndryshme falas;

ë) Zëvendësimet e materialeve të veshmbathjes brenda vlerës së normës”.

2. Emërtimi “Ministri i Rendit Publik” zëvendësohet me “Ministri i Brendshëm”.

3. Vendimi nr.503, datë 8.11.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normës 3/1 të veshmbathjes për ushtarët e shërbimit të detyrueshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha